

URDHËR
Nr. 330, datë 26.9.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN E MINISTRIT NR. 166, DATË
24.5.2019 “PËR PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR PAJISJEN
ME LICENCËN E “IMPORTIT TË SUBSTANCAVE OZONHOLLUESE” KODI
III.3, SI DHE PËR PEZULLIMIN/REVOKIMIN E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të kreut VII, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019, “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 2, të shtojcave 1/a dhe 1/b, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e urdhrit të ministrit nr. 166, datë 24.5.2019 “Për procedurat dhe dokumentacionin për pajisjen me licencën e “importit të substancave ozonholluese”, kodi III.3, si dhe për pezullimin/revokimin e saj”, te nënpika 2, togfjalëshi “Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (kodi UNIK)”, hiqet.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sektori i Monitorimit të lejeve dhe licencave në fushën e mjedisit, drejtoria përgjegjëse për politikën e substancave ozonholluese në ministri, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për fushën e mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi